



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja JavorePër sinjaliziminTë Guximshëm Pa Armë

Breaking News: Pogradec – Goditet një rast i kultivimit të bimëve narkotike, asgjësohen 610 bimë kanabisi
Raporti i ngjarjeve, 8 gusht 2024

Korçë – Plagosi me mjet të mprehtë, vëllanë e tij, një vit më parë, vihet në pranga

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit

Drejtoria Vendore e Policisë Fier, gjatë 24 orëve të fundit



08/08/2024

Pogradec – Goditet Një Rast I Kultivimit Të Bimëve Narkotike, Asgjësohen 610 Bimë Kanabisi

Pogradec/Kontroll intensiv i territorit, në kuadër të planit operacional anticannabis të koduar “Territor i pastër”.

Goditet një rast i kultivimit të bimëve narkotike, në fshatin Tallë. Asgjësohen 610 bimë narkotike cannabis sativa.

Vihet në pranga një 31-vjeçar që u kap në flagrancë duke u kujdesur për bimët narkotike.

Sekuestrohen 1 armë gjahu dhe municion luftarak, që u gjetën në tokën ku ishin kultivuar bimët narkotike.

Në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional kombëtar “Territor i pastër”, për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Pogradec kanë intesifikuar kontrollët në terren, duke u bazuar në inteligjencën policore. Si rezultat i kontrolleve, në vendin e quajtur “Uji i Ftohtë”, në fshatin Tallë, u gjetën të kultivuara 610 bimë narkotike cannabis sativa, të cilat u asgjësuan me anë të djegjes.

Gjatë kontrollit të territorit, u gjetën dhe 1 armë gjahu dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me 2 celularë.

Në vijim të veprimeve për këtë rast u arrestua në flagrancë shtetasi D. S., 31 vjeç, banues në fshatin Çermë-Sektor, Divjakë.

Vijojnë veprimet hetimore për identifikimin e shtetasve të tjerë për përfshirë në këtë rast të kultivimit të bimëve narkotike.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent